



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ŽA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENT" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

Psh. Nr. 1118/23

Paneli Shqyrtues i Prokurimit, i emëruar nga OSHP sipas nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës dhe nenit 32 të Rregullores së Punës në OSHP, në përbërje nga Isa Hasani – Kryetar, Vedat Poterqoi dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani – Anëtar, duke vendosur lidhur me kërkesën për "paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik" e parashikuar me nenin 99, paragrafi 2, i LPP, e parashtruar me datën 04.09.2023 nga Agjencia Qendrore e Prokurimit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) ndaj operatorit ekonomik "MEB" L.L.C, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së objektit" me numër të prokurimit UA/2016-23-8844-2-3-6, me 19.12.2023, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet si e bazuar kërkesa e datës 04.09.2023, Protokollin 1118/23 e Agjencia Qendrore e Prokurimit, e parashtruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), për shkak të paraqitjes të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, sipas nenit 99 paragrafi 2 të LPP-së, kurse OE "MEB" L.L.C diskualifikohet nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së objektit" me numër të prokurimit UA/2016-23-8844-2-3-6 dhe i ndalohet pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit publik për periudhën kohore 3 muaj, duke filluar nga data 19.12.2023 deri me datën 18.03.2024.
2. Urdhërohet AK, respektivisht Agjencia Qendrore e Prokurimit, që ta bej konfiskimin e sigurisë së tenderit për OE, me të dhëna si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi.
3. Do të revokohet masën e shqiptuar si në paragrafin 1, të dispozitivit të këtij Vendimi, nga dita kur dhe nëse OSHP njoftohet me aktin e organeve kompetente, sipas të cilit vërtetohet se vepra e kualifikuar sipas paragrafit 1 të dispozitivit të këtij vendimi nuk është kryer.

A r s y e t i m

Me 04.09.2023, Agjencia Qendrore e Prokurimit në cilësinë e AK, ka dorëzuar në OSHP kërkesë për aplikim të masave sipas nenit 99 pika 2 të LPP, ndaj Operatorit ekonomik “MEB” L.L.C, nën pohimin se ekziston dyshimi për “paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga ky operatorë ekonomik ashtu sikurse parashihet me nenin 99 par 2 të LPP.

Duke ju referuar kërkesës së cituar më sipër, konstatohet si arsye për marrjen e masave në pajtim me nenin 99.2 të LPP, AK (me të dhënat si më sipër) ka deklaruar se Operatori Ekonomik “MEB” L.L.C, në aktivitetin e prokurimit: “Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së objektit” me numër të prokurimit UA/2016-23-8844-2-3-6 është tërhequr nga aktiviteti i prokurimit pas hapjes së ofertave edhe pse më herët ka deklaruar se është i përgjegjshëm duke e nënshkruar deklaratën nën betim të cilën e ka dorëzuar së bashku me ofertë. Tërheqjen e ka arsyetuar me një kontest me ATK-në dhe si pasojë e mos zgjidhjes se këtij kontesti nuk mund të vazhdoj me tutje me këtë aktivitet.

Andaj duke u nisur nga këto prova AK - Agjencia Qendrore e Prokurimit kërkon nga OSHP që konform dispozitave ligjore të merren masa ndaj këtij Operatori Ekonomik.

Me datën 05.09.2023 OSHP e ka njoftuar “MEB” L.L.C, me kërkesën e AK - Agjencia Qendrore e Prokurimit për iniciimin e procedurës për paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar, parashikuar në kuptim të nenit 99 paragrafi 2 të LPP.

Operatori ekonomik “MEB” L.L.C me datën 05.09.2023 ka kthyer përgjigje duke theksuar “MEB” L.L.C sqaron se pas shpalljes së procesverbalit me datën 31.08.2023, ku shihet qarte që vetëm kompania jone “MEB” L.L.C kishte marrë pjesë në 2 Lotët (procesverbali i bashkangjitur Nr. 1), ishim të vetëdijshëm që tenderi do të anulohet nga ana e Autoritetit Kontraktues gjë që ndodhi me datën 04.09.2023, AK e bene njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit, (procesverbali i bashkangjitur Nr.2). Arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik, një dispozite në ligjin e prokurimit publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit. Ne për shkak të transparencës vendosem të i drejtohem Autoriteti Kontraktues ku ia sqaruar në pika të shkurta arsyen e tërheqjes tone nga procedurat e mëtutjeshme edhe pse ishim të vetëdijshëm se së shpejti AK do të anuloi tenderin në fjale për arsye të pjesëmarrjes së vetëm një Operatori Ekonomik po ashtu e informuam AK që për hir të procesit të prokurimit të mos zgjatet me shumë . Kjo gjë u keqpërdor nga ana e AK e cila me shkrese ju drejtua juve si OSHP. Ne ende nuk e kemi të qarte se perse Autoriteti Kontraktues ju është drejtuar juve si OSHP me kërkesë kur ne kemi qene ata që e kemi informuar për situatën aktuale dhe se ka mundur të na drejtohet neve për informata shtese. Te bashkangjitura i keni të gjitha kërkesat që kompani jone i është drejtuar ATK-se. Ne si kompani kemi menduar se kjo është zgjidhet shpejte me ATK-ne por është duke u zgjatur dhe ende nuk ka përfunduar.

Paneli shqyrtues pas analizimit të akteve dhe veprimeve të palëve dhe pretendimeve reciproke të tyre, konstatoj se lënda në rastin konkret përmban dokumente dhe shkresa të mjaftueshme, mbi bazën e të cilave Paneli ka të drejtë të vendos në aspektin meritator pa prezencën e palëve, sikurse parashihet kjo me nenin 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues gjatë analizimit të deklarimeve, shkresave dhe fakteve të lëndës, ka konstatuar se Operatori ekonomik ka qenë i vetëdijshëm për procedurat kontestimore me ATK-në para publikimit të njoftimit për kontratë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe si i tillë OE fillimisht është dashur të sigurohet se do të arrij marrëveshje me ATK para se të marr pjesë në këtë aktivitet të prokurimit apo para se ta nënshkruaj deklaratën nën betim për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Paneli Shqyrtues thekson se OE të cilët po marrin pjesë në aktivitete të prokurimit sidomos në procedurat me vlerë të vogël po tërhiqen pa ndonjë justifikim të mjaftueshëm pasi që zakonisht për procedura të tilla nuk po kërkohet sigurim i ofertës, dhe kjo po ju shkakton vonesa autoriteteve kontraktues siç ka ndodhur në rastin konkret ku AK - AQP është dashur të anuloj aktivitetin e prokurimit dhe institucionet publike të mbesin pa shërbime apo furnizime të cilat konsiderohen të domosdoshme. Si dhe OE janë të obliguar që të respektojnë parimet e përgjithshme të prokurimit publik mbi bazën e të cilave është miratuar Ligji për Prokurim publik dhe janë hartuar rregulloret dhe kodi etik për prokurim publik.

Duke u bazuar në faktet e vërtetuara në mënyrë të pavarur nga OSHP dhe të shpjeguara si më sipër, konsiderohen prova të mjaftueshme të cilat kanë krijuar bindjen e këtij Paneli se OE "MEB" L.L.C me, ka vepruar në kundërshtim me Rregullat Për Prokurim Publik dhe AK ka të drejtë të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së. Ashtu që, AK ka paraqitur në OSHP, me 04.09.2023, kërkesë për iniciimin e procedurës së diskualifikimit në kuptim të dispozitës së cituar si më sipër.

Paneli Shqyrtues konsideron se në këtë rast objektivisht lind detyrimi i OSHP, që ta zbatoj dispozitën e cituar si më sipër të LPP, sipas së cilës shprehimisht kërkohet që operatori ekonomik në rastin konkret të diskualifikohet nga pjesëmarrja në këtë aktivitet të prokurimit dhe (sipas gjykimit të pavarur të këtij Paneli) ti ndalohet e drejta për të marrë pjesë në aktivitet e prokurimit publik në periudhën kohore 3 muaj, duke filluar nga data 19.12.2023 deri me datën 18.03.2024. Megjithatë, Paneli Shqyrtues sqaron se masa e diskualifikimit, e shqiptuar dhe shpjeguar si më sipër, mund të revokohet nga momenti kur dhe/ose nëse OSHP njoftohet nga autoritetet kompetente se vepra e cituar dhe e komunikuar sipas paragrafit 1, të dispozitivit të këtij vendimi, nuk është kryer.

Paneli shqyrtues, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë me padi, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.